

Këndi i BE në Bashkinë Korçë



Krijimi i Këndit BE, është mbështetur nga “Bashkitë për në Evropë”, një projekt i financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri. Qëllimi i Këndit të BE-së është të sigurojë informacione në lidhje me BE, institucionet dhe politikat e saj, marrëdhëniet e Shqipërisë me BE, si dhe fondet e programet e Bashkimit Evropian të vlefshme për bashkitë Shqiptare, institucionet vendore dhe qytetare.

Këndi i BE:

- Të ndihmon të gjejsh informacion më të specializuar në lidhje me Bashkimin Evropian. Ky informacion mund të përmbledhë çdo gjë, që nga organizimi dhe zhvillimi i BE, deri në fusha politike të veçanta, të tilla si arsimi dhe trajnimi, shoqëria civile, mjedisi, politikat rajonale, zgjerimi dhe tregu i përbashkët, zhvillimi ekonomik dhe bujqësia.
- Ndihmon qytetarët për të kuptuar aspektet e ndryshme të procesit të integritetit të Shqipërisë në BE.
- Mund të ofrojë informacion në lidhje me fondet e Bashkimit Evropian të vlefshme për bashkitë, grupet e shoqërisë civile, individët, komunitetin e biznesit, studentët, fermerët, shkollat dhe universitetet.
- Mund të shpjegojë strukturat themelore të Bashkimit Evropian për shkollat fillore dhe të mesme.
- Mund të ndihmojë studentët e universiteteve që të informohen mbi edukimin në BE, trajnimet si dhe programe të tjera për të rinj.
- Mund të informojë median lokale, apo grupime të tjera mbi projektet dhe programet e mbështetura nga BE në Shqipëri.

Foto ilustruese- Këndi i BE, Bashkia Korçë

